



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par 2 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal Nr.04/L-010 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 26.01.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË TË BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMUNAL SHUMË-FUNKSIONAL

Neni 1

MIRATOHET, Marrëveshja e Bashkëpunimit e lidhur në mes të :

1. Kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës përfaqësuar nga Kryetari i Kryeqytetit;
2. Komunës së Podujevës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
3. Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
4. Komunës së Fushë-Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
5. Komunës së Graçanicës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
6. Komunës së Obiliqit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Shumë-Funksional protokoluar në Komunën e Lipjanit me Nr.01-660/03-69356, e datës 21.12.2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratet përkatëse komunale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nr. 15-020/08-5687

Lipjan, më 26.01.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

